



VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 20 mars 2012

Numri i lëndës 2011-25

Z. Shaip Gashi

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 20 shkurt 2012, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, dhe Rregulloren e Punës së Panelit të datës 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 7 dhjetor 2011.

II. FAKTET

2. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve që janë në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si në vijim.

3. Parashtruesi i ankesës ishte lënduar në punë në Gjermani në vitin 1979, dhe pas kësaj kishte marrë pushim mjekësor. Kërkesa e tij për pension invalidor ishte parashtruar në vitin 1981. Që prej vitit 2002 ai pretendon se ka gëzuar të drejtën për një pension invalidor nga Gjermania. Duket se ai nuk ka marrë ndonjë pagë, përkundër kërkesave, ankesave dhe korrespondencave të tjera që i ka bërë me vite tek institucionet private dhe publike të pensionit, tek autoritete të tjera dhe gjykata në Gjermani.
4. Përpos kësaj, ai ka kërkuar ndihmë nga UNMIK-u, KFOR-i, Avokati i Popullit të Kosovës dhe EULEX-i, e që asnjëri prej tyre nuk kanë qenë në gjendje t'i ndihmoj atij rreth kësaj çështje.

III. ANKESAT

5. Parashtruesi i ankesës kërkon nga Paneli që t'i ndihmojë rreth kësaj çështje dhe t'i sigurojë që ai të merr pagën e asaj çka kupton ai si pension.

IV. LIGJI

6. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
7. Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, siç përcaktohet në Rregullën 25, paragrafin 1 të Rregullores së vet të Punës.
8. Rasti i parashtruesit të ankesës ka të bëjë me pagesat e pensionit për të nga një kompani private e sigurimit në Gjermani dhe/apo nga një Institut Shtetëror gjerman për pension.
9. Këto çështje të ngritura në këtë ankesë nuk bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë, mandat i cili kufizohet në çështjet që lidhen me drejtësinë, policinë dhe doganat.
10. Fakti se parashtruesi i ankesës ka kontaktuar EULEX-in në Kosovë për tu këshilluar, nuk e bien rastin brenda mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë. Prandaj, kjo çështje nuk bie në kuadër të mandatit të Panelit, siç saktësohet në Rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar këtë ankesë,

gjen se sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës, ankesa është e pabazuar, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit